

BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET - VITI I DYTË- SEMESTRI III

Kontabilitet Financiar [O]: 7 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të pajisen me dituri bazike dhe të thelluara me fushën e kontabilitetit financiar, të aftësohen në detyrimet afatshkurta dhe afatgjate, do të njoftohen me efektin e ortakërive, financimin e korporatave përmes ekuitetit dhe përmes borxhit, do të aftësohen në pasqyrat e cash-flowit, duke e analizuar pasqyrat financiare përmes treguesve financiar. Studentët gjithashtu do të shohin obligacionet e pagueshme, pasqyrat e rrjedhjes së parasë, të mësohen në krijimin PF individuale, në trajtimin kontabël të tatimeve dhe taksave etj.

Bazat e Marketingut [O]: 6 ECTS

Qëllimi i lëndës së Bazave të Marketingut është që pas mbarimit të kësaj lënde studentët të njoftohen me njohurit bazë të marketingut, të njoftohen me përcaktimet e marketingut dhe shpjegimet e tendencave teorike dhe metodike se pse ekziston ky sistem i marketingut, të aftësohen në organizmin e marketingut në përgjithësi, të i përdorin instrumentet kryesore, shtimin e vlerës së produkteve në lidhje me kohën, formën e vendin, të i vlerësojnë faktorët kyç që veprojnë në performancën e marketingut.

Paraja dhe Financa [O]: 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohurit e duhura për paranë, financat, tregun dhe institucionet financiare në përgjithësi, të aftësohen në funksionet e parasë dhe financave në raport me konsumatorin, teoritë e kërkesave për para, inflamacionin dhe sistemin financiar, të njoftohen me tregun e parasë, unitetin e institucioneve të parasë dhe institucioneve financiare.

Mikroekonomia [O]: 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të marrin njohurit e avancuara të Mikroekonomisë me gjitha asetet që i përfshin kjo lëndë, të avancohen në kuptimet e

vendim-marrjes ekonomike, në analizat marginale, me dështimet e tregut, me mënyrën ekonomike të menduarit, të ndërtoj dhe interpretoj grafiket e diagrameve dhe të aftësohet në funksionimin e tregut të produkteve.

Bazat e Menaxhmetit [Z]: 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde që studentët të fitojnë njohurit për parimet dhe bazat e menaxhmentit, duke u fokusuar në planifikimin, organizimin, udhëheqjen dhe kontrollin e proceseve të menaxhuarit. Kështu do të aftësohen në zgjidhjen e problemeve konkrete të menaxhimit në ekonomi dhe biznes, të pajisen me njohurit e menaxhimit bashkëkohor, teknikat dhe metodat e menaxhimit modern.

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore [Z]: 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është studentët të njohohen me ndikimin e menaxhimit e resurseve njerëzore, të mësojnë metodologjia të zhvillimit të resurseve njerëzore duke i zbatuar ato praktikisht në çfarëdo ndërmarrje. Do të aftësohen edhe në aspektet praktike të menaxhimit të resurseve njerëzore apo menaxhimit strategjik të resurseve njerëzore.

Menaxhimi i Sistemit të Informacionit [Z]: 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të pajisen me dituritë e nevojshme për një sistem të informacionit të mirëfilltë. Pas kësaj, studentët do të aftësohen të menaxhojnë këtë sistem, duke përdor teknikat dhe politikat më të mira bashkëkohore. Krahas menaxhimit, studentët do të njohohen edhe me kontrollin e sistemeve të informacionit, kontrollin përbërësve të këtij sistemi: pjesët harduerike, softuerike, burimet njerëzore, proceset biznesore, rrjetat etj.

BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET - VITI I DYTË- SEMESTRI IV

Bankat dhe afarizmi bankar [O]: 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të njohohen me bankat bashkëkohore, organizatat financiare ndërkombëtare, sistemin bankar të vendeve të zhvilluara, politikat afariste e bankare. Do të jenë në gjendje të aftësohen me qarkullimin e pagesave në vend e në vendet botërore, do të njohohen me sistemin informativë bankar, me marketingun e afarizmit bankar dhe do të shohin modele në krijimin, menaxhimin dhe veprimtaritë kryesore të bankave afariste.

Financat e Korporatave [O]: 7 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është studentët të marrin njohurit e duhura për financat e bizneseve të mëdha – korporatave, bizneseve specifike dhe organizatave si shoqëri aksionare, të aftësohen në menaxhimin e këtyre financave të korporatave, të analizojnë dhe njohin problemet e korporatave në aspektet financiare duke ia mundur që edhe praktikisht zgjidhjen e këtyre problemeve me njohuritë e fituara më herët.

Kontabiliteti i Menaxhmentit [O]: 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që të studentët të aftësohen në përgatitjen e informatave të nevojshme nga kontabiliteti menaxherial si informata të dedikuara për menaxhmentin, të njihen me veglat e kontabilitetit të menaxhmentit që përdoren në raste të ndryshme të vendim-marrjes. Rëndësia e kësaj lënde është se studentët do të aftësohen në marrjen e vendimeve afariste duke zgjedh shumë paqartësi afariste, ti shohin proceset e kontabilitetit të kostos, kornizat e planifikimit dhe kontrollit të buxhetimit të operacioneve, analizave të shpenzimit, vëllimit dhe fitimit.

Menaxhimi i Riskut [O]: 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të aftësohen në procesin e identifikimit, vlerësimit, kontrollit dhe monitorimit të situatave që potencialisht janë të dëmshme për arritjen e objektivave dhe nga të cilat të jepet një garanci e arsyeshme që këto objektiva vërtet do të arrihen. Risku ndërlidhet edhe me vendimet që vlerësohen me probabilitet të lartë në ndryshim të rezultateve.

E-Biznesi [Z]: 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është studentët të njohohen me konceptet e duhura të disa modeleve bashkëkohore të zhvillimit të biznesit elektronik: B2B, B2C, C2C, C2B. Do të njohohen me konceptet e tregtisë elektronike (E-commerce), e-marketing, e-banking, të njohohen me proceset biznesore të realizuara përmes teknologjisë së informacionit e veçanërisht përmes internetit ose në mënyrë elektronike.

Sjellje Organizative [Z]: 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të aftësohen në sjelljet organizative, sjelljet ndaj konsumatorëve, të i studiojnë sjelljet dhe mënyrat organizative që një institucion apo kompani të përfitoj në numrin e konsumatorëve, i studiojnë vendimet dhe sjelljet e konsumatorëve para dhe pas blerjeve. E gjitha është që studentët të nxjerrin informacione të sakta se çka e dërgon të ndryshoj sjellja organizative brenda një institucioni.

Menaxhimi i NVM [Z]: 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët pas përfundimit të kursit të jenë në gjendje të identifikojnë definicionet alternative të ndërmarrjeve dhe bizneseve të vogla dhe të mesme. Të aftësohen në menaxhimin e këtyre ndërmarrjeve, të vlerësojnë rolin e ndërmarrsisë dhe NVM në ekonominë kombëtare dhe ndërkombëtare. Studentët do të shohin se si krijohen dhe menaxhohen proceset e këtyre ndërmarrjeve, të aftësohen në menaxhimin e barrierave dhe tejkalimin e tyre.

Financat e NVM [Z]: 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të marrin njohurit e duhura të financave të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, të aftësohen në përpilimin e një plani financiar të përpikt për këto ndërmarrje, leximin e pasqyrave financiare, menaxhimin e financave dhe proceseve financiare të NVM.